

STATUTI

I Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “DIZAYN LIFT” shpk

Personi qe firmos me poshte:

- Kenan ÇAKMAK, me nr ID I10320244G lindur me 20.03.1981, ne Horasan Turqi dhe banues ne Tirane.

Ne baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare “, krijojne Statutin e ketij subjekti, perkatesisht Shoqerise.

KREU 1

Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.

- (1) Sot me date 07/01/2021, une themeluesi Kenan Çakmak, kam vendosur, te krijoj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare “, dhe aktet e tjera nenligjore qe jane ne fuqi. Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar, i cili do te ushtroje aktivitetin privat ne Territorin e Republikes se Shqiperise, pas regjistrimit ne QKB.

- (2) Themelues i Shoqerise eshte;

Kenan ÇAKMAK, me ID nr I10320244G, atesia Hikmet. I datelindjes 20.03.1981 dhe banues ne Rrugen “Migjeni, Nd.2, H.10, Ap.2. Yzberisht Kashar” Tirane

Neni 2

Emertimi

Emri I Shoqerise eshte “DIZAYN LIFT” shpk

Neni 3

Objekti

Ushtrimi I akvitetit Import & Export ashensora, pjese kembimi ashensori dhe makinash. Shitje- blerje dhe servis makinash. Marje projektesh, administrim pallati dhe ashensori. Shitje blerje hyrjesh.

Neni 4

Kohëzgjatja



Kohezgjatja e Shoqerise, do te jete e pakufizuar. Ajo mund te Shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se Ortakeve

Neni 5

Selia

(1). Selia e Shoqerise ndodhet ne adrese Rruga "Migjeni, Nd.2, H.10, Ap.2. Yzberisht Kashar" Tirane

(2) Adresa e faqes zyrtare te Internetit (nese ka) eshte: Nuk ka!

(3) Adresa e Shoqerise, per qellime komunikimi elektronik (nese ka) eshte si vijon
Dizayn.lift21@gmail.com

Neni 6

Shoqeria ka Vulen e Saj ku jane te percaktuara inicialet e emertimit te saj, NIPTI dhe adresa baze.

KREU II

Kapitali

Neni 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar, njekohesisht dhe Kapital Themeltar i Shoqerise eshte; 100 000 (njqind mije) leke, perkatesisht ne nje kuote me vlere 100 000 leke

Kapitali Themeltar perbehet nga Kontribute ne vlere monetare shuma 100 000 leke.

Neni 8

Pjesemarrja e Themeluesve ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise eshte ne përrputhje me kontributet e meposhtme;

- Ortaku Kenan ÇAKMAK, zoterues I 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100 000 leke, qe perben 100 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe kontributet ne natyre, gje e cila arrihet nepermjet emerimit ne rruge ligjore te nje eksperti te autorizuar, per keto kontribute sipas kerkeses se paraqitur nga nje person I autorizuar nga te gjithë ortaket.

Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi I Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqesojnë.

Neni 10

Transferimi I Kapitalit

Kuotat e Kapitalit në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit në kapitalin e Shoqërisë
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 11

Organet Vendimarrëse

Asambleja e Ortakëve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel të Autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për Administratoret, Likujduesit dhe Ekspertët Kontabel të Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve për ecurinë e veprimtarisë.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Përfaqësimin e Shoqërisë në Gjykatë të të gjitha niveleve si dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me Organet e Qeverisë Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

- Miratimin e rregullave procedurale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë.

Administratori I Shoqerise (ne rastin kur nuk eshte Ortak), nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Autorizimi I perfaqsimi mund te jepet vetem per nje mbledhje asambleje te pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose, nese parashikohet nga Statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permbaje; vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Pergjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, për te marre vendime pavarsisht parregullsise.

Neni 13

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 (tridhjetë) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesemarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres,per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
- d) Percaktimin e shperblimeve,
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- g) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
Cdo ndryshim statute duhet t e depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar,I autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi,ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 16

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.Afati I emerimit eshte 5 vjet,me te drejte ripertesitje.Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji,nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas.Cdo emerim I bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte I pavlefshem.
- (3) Personi i meposhtem caktohet si Administratore I shoqerise

Te dhenat e identifikimit:
(mbiemrat,emrat,adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimet:

___Kenan Çakmak___ me ID I10320244G___

Atesia; ...Hikmet.....,

Datelindja: 20.03.1981, me adrese Rruga "Migjeni, Nd.2, H.10, Ap.2. Yzberisht Kashar" Tirane

Neni 17

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqërise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregtare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- d) Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregtare.
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlere me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 20 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne Fuqi.

Neni 18

Pergjegjesia e e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe I sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", administratori detyrohet;
 - a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara me ligj dhe në statut, me mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
 - b. Të ushtrojë kompetencat që i njohën me ligj dhe me Statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
 - c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
 - d. Të parandalojë dhe menjajtojë rastet e konfliktit , prezent, apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë.
 - e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë Tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.
3. Nëse, Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë Shoqërisë dëm që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal, që ata apo, personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt, e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë Shoqërisë dëm të shkaktuar nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", kryen veprimet e mëposhtme:
 - U kthen ortakëve kontributet
 - U paguan ortakëve interesat apo dividende
 - U shperndan aktivitetet e Shoqërisë
 - Lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
 - Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të njëjtin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asambleës nuk mund të pengojë ngritjen e kërkesës padise kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti financiar – ekspertet



Neni 19

Viti financiar

Viti financiar I shoqerise fillon me date 1 janar dhe perfundon me date 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 21

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise pagueve,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve,brenda 20 diteve pas prishjes,cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

Neni 22

Riorganizimi I shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statudhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipetare.

ORTAKET
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ORTAKU

Kenan ÇAKMAK

KENAN ÇAKMAK


